



Отворете
ги прозорците

Нарни dritaret

Shoqata për teknologji asistuese

contact@openthewindows.org

www.openthewindows.org

STRATEGJIA ORGANIZATIVE (2015-2017)

Shkup, 2015

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	Error! Bookmark not defined.
HYRJE	Error! Bookmark not defined.
Analiza e mjedisit	Error! Bookmark not defined.
Përshkrim i gjendjes organizative	Error! Bookmark not defined.
Definim të termave kyçe	Error! Bookmark not defined.
SYNIME AFATGJATA	Error! Bookmark not defined.
Vizioni dhe misioni	Error! Bookmark not defined.
Vlera dhe parime	Error! Bookmark not defined.
Qëllime afatgjata	Error! Bookmark not defined.
PRIORITET STRATEGJIK	Error! Bookmark not defined.
Përdorues	Error! Bookmark not defined.
Mësim dhe zhvillim	Error! Bookmark not defined.
Procese të brendshme	Error! Bookmark not defined.
Financa	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 1: Plani i aksionit për fushën strategjike: Përdorues	22
ANEKS 2: Plani i aksionit për fushën strategjike: Mësim dhe zhvillim	23
ANEKS 3: Plani i aksionit për fushën strategjike: Procese të brendshme	25
ANEKS 4: Plani i aksionit për fushën strategjike: Financa	26

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në prag të përvjetorit të dhjetë, Hapni dritaret e përgatit Strategjinë organizative për periudhën 2015-2017. Ajo paraqet platformë të pajtuar për veprimin dhe zhvillimin e ardhshëm, në pajtueshmëri me ndryshimet në mjedis.

Zhvillimi i ngadaltë social, ekonomik dhe politik në Maqedoni dhe mjedisi jo mjaft nxitës për sektorin qytetar e përcaktojnë kontekstin e përgjithshëm. Faktorë të rëndësishëm të jashtëm janë përmirësimi gradual i inkluzivitetit të shoqërisë maqedonase dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informativo-komunikuese dhe asistuese.

Hapni dritaret është organizata e vetme në Maqedoni dhe më gjerë në rajon e përkushtuar plotësisht në promovimin e teknologjisë asistuese. Ajo u rrit në organizatë të mirënjohur dhe të njohur që e përdor teknologjinë si vegël për nxitje të inkluzivitetit të personave me pengesë.

Afrimi i teknologjisë asistuese për personat me pengesë dhe promovimi i saj në shoqëri janë arritja më e lartë e Hapni dritaret. Organizata i kreu suksesshëm hapat pionere për futje të teknologjisë asistuese në arsimin e rregullt fillor.

Hapni dritaret është fitues i Çmimit për integrim social i Fondacionit ERSTE në vitin 2013 dhe e Çmimit për inkluzion dixhital e UNITE IT në vitin 2014.

Në periudhën e ardhshme, organizata do t'i investojë të gjitha potencialet e saj që ta vazhdojë veprimin dhe zhvillimin e suksesshëm. Si përgjigje e ndryshimeve në mjedis, Hapni dritaret para vetes vendos synime të reja afatgjata:

Vizioni është “botë me njerëz të barabartë dhe aktivë që e përdorin teknologjinë për zhvillim vetjak, përmirësim të kualitetit të jetës dhe për mirëqenien e shoqërisë”. Misioni i organizatës është “me teknologji asistuese ta nxitë dhe lehtësojë përfshirjen aktive të të gjithë njerëzve në botën bashkëkohore”.

Veprimi do të jetë i drejtuar ndaj këtyre qëllimeve afatgjata:

- teknologji informativo-komunikuese të disponueshme për të gjithë,
- arsim inkluziv dhe modern,
- mundësi të barabarta për të gjithë, dhe
- OP (HD) - organizatë inovative me kredibilitet dhe aftësi për partneritete

Njerëzit dhe nevojat dhe aftësitë e tyre individuale do të jenë në fokus. Punimi do të themelohet në dy qasje themelore: qasje të drejtuar drejt personit (person-centered) dhe qasje të themeluar mbi të drejtat (rights-based approach).

Organizata do të vazhdojë t'i kujdesë vlerat kyçe: pjesëmarrjen, mundësi të barabarta, tolerancë, partneritet dhe transparencë e përgjegjësi.

Qëllimi i kësaj strategjie është të përforcohet kapaciteti i OP (HD) për zhvillim të shërbimeve dhe produkteve të reja si përgjigje ndaj nevojave dinamike të përdoruesëve. Ajo ofron zgjidhje për sfidat të lidhura me rritjen e organizatës që do ta aftësojnë Hapni dritaret që të vazhdojë në rrugën e realizimit të vizionit dhe misionit vetjak.

Plani strategjik është pikërisht - plan, kuadër. Që të realizohet, përbërës të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm janë potenciali dhe aftësitë e të punësuarëve dhe anëtarëve të trupave drejtuese dhe mbështetja nga përdoruesit dhe bashkëpunimi me ta. Sinergjia e tyre, ashtu si edhe deri tani, do ta shëndrojë planin në realitet.

HYRJE

Strategjia e organizative e Shoqatës për teknologji asistuese Hapni dritaret OP (HD) i jep drejtimet kryesore për veprimin dhe zhvillimin organizues në periudhën për vitin 2015 - 2017

Strategjia është e përpunuar nëpër procesin e pjesëmarrjes në konsultime dhe planifikim dhe është pasqyrim i vlerave, qëllimeve dhe pritjeve të ndara të palëve të përfshira:

Përgatitja filloi në fundin e vitit 2013 me vlerësimin organizativ gjithëpërfshirës - holignoza. Vlerësimi dha tregim objektiv të anëve të forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet, sipas vëzhgimeve të palëve të brendshme dhe palëve të jashtme kyçe. Analiza e detajuar e mjedisit në gjysmën e parë të 2014 mundësoi që të identifikohen masa për shfrytëzim të mundësive dhe për përbalim me kërcënimet. Elementet themelore të strategjisë ishin të planifikuara në punëtorinë treditore në korrik të vitit 2014 nga ana e anëtarëve të Bordit drejtues dhe të punësuarëve në OP (HD).

Procesi i përgjithshëm i përgatitjes ishte i udhëhequr nga ana e shtëpisë konsultuese Qendra DETRA dhe e mbështetur financiarisht nga USAID Maqedoni

Analiza e mjedisit

Kontekst i përgjithshëm

Nga dita e pavarësisë, integrimet euro-atlantike janë synimet prioritare të shtetit. Përballë përparimit në plotësimin e kriterëve për anëtarësim, Maqedonia ende nuk është anëtare e plotë e BE-së dhe e NATO-s, së pari për shkak të çështjes së pazgjidhur për emrin.

Shteti investon mundime dhe në masë të madhe arrin sukses që t'i harmonizojë legjislacionin vendas dhe politikat publike me rekomandimet dhe standardet e BE. Suksesit është më i vogël në zbatimin e politikave publike, si edhe mungesë e mjeteve për plotësimin e vendimeve ligjore.

Situata politike në vitet e fundit pasqyrohet me konfrontime midis strukturave qeverisëse edhe të opozitës, mungesë të dialogut dhe polarizim të fuqishëm me linjë partiake dhe etnike. Çështjet ditore-politike janë në fokusin e vëmendjes, për llogari të zhvillimit social dhe përparimi i të drejtave të njerëzve dhe qytetarëve.

Shteti përballet relativisht mirë me krizën financiare europiane dhe botërore nga viti 2008 dhe 2009 dhe realizon norma të vogla, por pozitive të rritjes ekonomike. Megjithatë, papunësia dhe standardi i ulët jetësor mbeten problemet kyçe për shumicën e qytetarëve¹. Vazhdon shtresëzimi social dhe rritja e boshllëkut ndërmjet shtresave të pasura dhe shtresave të varfëra të popullsisë².

Zhvillimi i demokracisë pjesëmarrëse zhvillohet me vështirësi. Mosbesimi i qytetarëve në sistem e ngadalëson zhvillimin e aktivizimit qytetar. Kultura politike nuk nxit debate të gjera shoqërore gjatë marrjes së vendimeve.

¹ Shembull, hulumtim i Institutit ndërkombëtar republikan (INR) nga [shtatori 2014](#).

² Sipas të dhënave të Bankës botërore për rinovim dhe zhvillim, Maqedonia në vitin 2011 është midis tre vendeve të para në Europë për shpërndarje të pabarabartë të të ardhurave kombëtare.

Gjendja e sektorit qytetar

Sektori qytetar në Maqedoni është ende i rrënjëzuar në mënyrë të pamjaftueshme në shoqëri. Mjedisi nuk është nxitës, përballë përmirësimeve të caktuara.

Ligji për shoqata dhe qytetarë (LSHQ) nga viti 2010 mundësoi që shoqatat qytetare të kryejnë veprimtari me të cilat mund të realizohet fitim, të cilat janë të obliguara ta përdorin për realizim të qëllimeve organizative. LSHQ e futi statusin “organizatë e interesit publik” si bazë për lehtësime plotësuese tatimore dhe lehtësime të tjera. Organizatat qytetare mund të shfaqen si furnitorë të mallrave dhe shërbimeve për institucionet publike³ ose të kryejnë veprimtari nga fusha e mbrojtjes sociale për llogari të shtetit⁴. Në praktikë, zbatimi i këtyre dispozitave zhvillohet në mënyrë të vështirësuar dhe të ngadalësuar dhe nuk i solli përfitimet e pritura.

Korniza tatimore është relativisht e pafavorshme, duke pasur parasysh se organizatat qytetare, të marra në përgjithësi, janë të barazuara me personat e tjerë juridikë në pikëpamje të tatimeve.

Ligji për vullnetarizëm lejon angazhim të vullnetarëve dhe i rregullon marrëdhëniet ndërmjet vullnetarit dhe organizatës.

Pjesëmarrja e organizatave qytetare në krijimin e ligjeve dhe politikave publike është e pakënaqshme, edhe pse Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me organizatat qytetare e vërteton nevojën dhe kuadrin për të. Ligji për qasje drejt informacioneve të karakterit publik zbatohet në mënyrë jokonsistente, që i vështirëson mundimet e organizatave të marrin pjesë në procesin e vendosjes dhe e ndjekin zbatimin e ligjeve dhe politikave publike.

Në anën pozitive, institucionet publike janë zakonisht të hapura për bashkëpunim me sektorin qytetar për aktivitete që institucioneve u mundësojnë që ta kryejnë më lehtë veprimtarinë themelore ose t'i mbështesin synimet e tyre strategjike.

Qytetarët ende nuk besojnë mjaftueshëm në organizatat qytetare⁵. Pjesë e madhe e qytetarëve konsiderojnë se përfshirja në organizata është e motivuar nga arsye fitimprurëse dhe se partitë politike kanë ndikim të fuqishëm mbi to. Gjithashtu, ekziston besim se organizatat qytetare janë të fokusuara në zbatimin e prioritetëve të mbështetësve të tyre nga jashtë, përballë nevojave dhe prioritetëve të grupeve të tyre qëllimore.

Bashkëpunimi midis sektorit qytetar dhe atij të biznesit nuk është i zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme. Megjithatë, gradualisht përforcohet ndërgjegjja e kompanive për përgjegjësinë e tyre shoqërore (korporative), që e nxitin bashkëpunimin ndërmjet dy sektorëve.

Sektori qytetar vazhdon të jetë i pavarur nga mbështetja e huaj financiare. Largimi i donatorëve “tradicionale” është vetëm pjesërisht e zëvendësuar me mbështetje të burimeve vendase dhe nga BE.

Mjetet e buxhetit shtetëror janë të pamjaftueshme dhe ndahen vetëm për mbështetje të projekteve nëpërmjet thirrjes transparente publike. Mbështetja institucionale (organizuese) sigurohet për aleancat nacionale të personave me pengesa, që janë të vetmit përdorues të mjeteve të fondit nga loja fati dhe deri në loja zbatimëse. Mjetet që i siguron qeveria lokale për organizatat qytetare, të marra në përgjithësi të parëndësishme dhe të destinuara për mbështetje projektuese.

Organizatat qytetare nuk sigurojnë mbështetje të rëndësishme financiare nga sektori i biznesit dhe nga donacionet individuale të qytetarëve. Lehësimet e parashikuara tatimore për firmat që dhurojnë mjete për organizata qytetare nuk janë mjaft të nxitura dhe janë të mbirëduara me procedurë vëllimore të gjatë administrative⁶. Ligji për tatimin personal mbi fitimin mundëson që

³ Në pajtueshmëri me Ligjin për prokurim publik.

⁴ Në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtje sociale.

⁵ Shembull, hulumtim i Institutit ndërkombëtar republikan (INR) nga [shtatori 2014](#).

⁶ Procedura është e rregulluar me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike.

qytetarët të dhurojnë pjesë të tatimit personal për organizatë qytetare, por procedura e parashikuar praktikisht e pamundëson atë.

Qasja ndaj fondeve të BE është vështirësuar nga standardet dhe kërkesat e larta për pranueshmëri. Mjetet nga BE të destinuara për sektorin qytetar maqedonas ndahen vetëm për mbështetje të projekteve nëpërmjet thirrjeve tematike publike, në të cilat lajmërohen në mënyrë drastike më shumë organizata nga sa mund të mbështeten.

Organizatat qytetare bashkëpunojnë në mënyrë të pamjaftueshme ndërmjet tyre për pyetjet kyçe të interesit të përgjithshëm. Shfaqjet e përbashkëta janë të rralla, të iniciuara nga ana e donatorëve ose facilitatorëve të huaj dhe kanë kohëzgjatje të shkurtër.

Konteksti në fushën e veprimit

Konteksti specifik në fushën e veprimit të HD është kryesisht i përcaktuar nga përmirësimi i ngadalshëm por i vazhdueshëm i inkluzivitetit të shoqërisë maqedonase dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informativo - komunikuese dhe asistuese:

Përmirësimi i përfshirjes së personave me pengesë është pothuajse nevojë e njohur konsensuale nga shoqëria. Edhe pse ajo është bazë e mirë nisjeje, mbështetja është kryesisht deklarative. Publiku e kupton nevojën që të përparohen të drejtat e personave me pengesë, por ende pengesa shihet kryesisht nëpër prizmen e dhembshurisë, bamirësisë dhe paradigmës mjekësore. Kuptimi i qasjes është i kufizuar në qasje fizike, sigurimi i së cilës edhe më tej mbetet sfidë.

Në vitin 2011, Kuvendi e ratifikon Konventën e HD për të drejtat e personave me pengesë, por futja dhe zbatimi i rregullores dhe politikës në frymën e paradigmës sociale për pengesë nuk zhvillohet me dinamikën e nevojshme.

Vazhdojnë mundimet që të përmirësohet inkluziviteti në sistemin arsimor, edhe pse me vëllim të kufizuar. Zmadhohet numri i shkollave që ekuipohen me defektologë dhe ndërmarrin masa për përmirësim të qasjes fizike. Këto trende janë karakteristika për arsimin fillor, por më pak hasen në arsimin e mesëm (i detyrueshëm nga viti 2009) dhe nivelet e tjera arsimore. Nga ana tjetër, në të gjitha nivelet arsimore mungojnë masa sistematike për përforcim të kapacitetit të mësuesëve për punë me nxënës me pengesë dhe për sigurimin e mjeteve qasëse me burim vizual, pajisje kompjuterike, duke përfshirë pajisje asistuese dhe softuer.

Zbatimi i strategjisë Kombëtare për zhvillim të e-përmbajtjeve (përmbajtjeve elektronike) për mbështetje të kompjuterizimit të arsimit 2010-2015 zhvillohet në mënyrë të ngadalshme. Librat mësimorë elektronikë të përpunuar nuk u përgjigjen nevojave të nxënësve me pengesë, edhe pse strategjia parashikon se të gjitha e-përmbajtjet (përmbajtjet elektronike) duhet të jenë të arritshme.

Gradualisht përforcohet ndërgjegja për nevojën nga inkluzioni dixhital për të gjithë qytetarët. Strategjia kombëtare për e-përfshirje (përfshirje elektronike) 2011-2014 arriti rezultate të caktuara për promovimin e teknologjisë asistuese dhe qasjen-internet. Të gjitha klubet falas të internetit janë të pajisura me pajisje asistuese. Standardet për qasje-interneti janë të përkthyer në gjuhën maqedonase. Zhvillimi i softuerit për sintezë të folurit në gjuhën maqedonase është filluar, por zhvillohet në mënyrë të ngadalshme.

Teknologjia informativo-komunikuese (TIK) vazhdon të zhvillohet në mënyrë të shpejtë. Disa nga trendet botërore kyçe përfshijnë:

- pajisjet mobile e ndërmarrin vendin udhëheqës nga kompjuterat,
- zhvillohen në mënyrë intensive aplikacione mobile,
- zmadhohet oferta dhe aplikimi i shërbimeve të ndryshme online,
- zmadhohet aplikimi dhe zvogëlohet çmimi i printimit 3D,
- shfaqja dhe zhvillimi i klaudivit kompjuterik (cloud computing), dhe
- zhvillohen zgjidhje për mbështetje të stileve të reja të mësimin nëpërmjet internetit.

Gjithashtu, është i dukshëm përparimi në aplikimin e parimit në dizajn universal: gjithnjë e më shumë prodhime harduer dhe softuer janë të qasura në mënyrë universale dhe janë të dizajnuara që t'i plotësojnë nevojat individuale të përdoruesëve. Platformat e reja për zhvillim të

faqeve të internetit dhe përmbajtje të tjera interneti i integrojnë standardet themelore për qasje - interneti, duke e përmirësuar qasjen në hapësirën virtuale.

Teknologjitë e reja janë të pranishme dhe bëhen ekonomikisht më të disponueshme në tregun maqedonas, duke përfshirë pajisje të caktuara asistuese ose pajisje hardueri të themeluara në dizajn universal, si: tastiera me butona të mëdha, trakboll, ekran me prekje, teknologji-kinekt, tabela smart etj. Megjithatë, nuk ekziston ofertë e rregullt e pajisjeve më specifike asistuese si për shembull, pajisje për kontroll të kompjuterit me shikim.

Në vend mungojnë aplikacione të zhvilluara ose të lokalizuara në gjuhën maqedonase ose në ndonjë nga gjuhët e komuniteteve të tjera etnike në vend, që i zvogëlon mundësitë për përfshirje dixhitale të grupeve të marginalizuara. Veçanërisht ndjehet mungesa e aplikacioneve arsimore në maqedonisht dhe në gjuhët e komuniteteve të tjera etnike që do të mund të ishin mbështetje në procesin arsimor dhe në mësimin në përgjithësi.

Përshkrimi i gjendjes organizative

HD është organizata e vetme në Maqedoni dhe në rajonin më të gjerë e përkushtuar plotësisht në promovimin e teknologjisë asistuese. Nga themelimi në vitin 2005, HD u rrit në organizatë të mirënjohur dhe të njohur që e përdor teknologjinë si vegël për nxitje të inkluzionit të personave me pengesë.

Veprimi i organizatës zhvillohet në dy veprimtari themelore:

Nga njëra anë, HD është **shërbim servisor** (service provider) për teknologji asistuese që ofron tre lloje shërbimesh për persona me pengesë: mbështetje të individualizuar për përdorim të kompjuterit dhe internetit, vlerësim individual të nevojave nga teknologjia asistuese dhe mbështetje këshillëdhënëse-konsultative për zbatim të teknologjisë asistuese.

Shërbimet janë të themeluara mbi qasjen e drejtuar drejt personit (person-centered approach) dhe kanë për qëllim ta nxitin zhvillimin personal të përdoruesëve. Zbatimi i teknologjisë asistuese, duke përfshirë softuer qasës, dhe ekipin profesional të defektologëve dhe profesionistëve të informatikës e bëjnë HD shërbim unik servisor në vend. Shërbimet janë pa pagesë. Interesi për ato e tejkalon kapacitetin e organizatës, për çka është futur lista e pritjes.

Nga ana tjetër, HD zbaton **projekte** për promovimin e zbatimit të teknologjisë asistuese nëpërmjet: përforsimit të kapacitetit të palëve të tjera, zhvillim të risive dhe hulumtimeve, dhe përforsim të ndërgjegjes dhe informimit.

Përforsimi i kapacitetit të palëve të tjera zhvillohet nëpërmjet kurseve dhe shpërndarjes së dijes dhe knowhow, për çka HD ndërtoi kapacitete solide dhe fitoi përvojë të rëndësishme. Shpërndarja e dijes dhe knowhow përfshin përgatitje dhe dhënie të parimeve dhe materialeve të tjera resurse dhe konsultime e këshilla për zbatim të teknologjisë asistuese. Përveç se në maqedonisht, një pjesë e materialeve janë të disponueshme edhe në gjuhën shqip edhe në anglisht. Në kuadër të përforsimit të kapacitetit, HD siguron edhe mbështetje për pajisje me teknologjinë asistuese të palëve të tjera.

Zhvillimi i risive përfshin përpunim të pajisjeve asistuese dhe përshtatje të pajisjeve standarde në zgjidhje asistuese dhe lokalizim dhe zhvillim të aplikacioneve arsimore. Organizata krahason hulumtime dhe zhvillon praktika (modele) të lidhura me zbatimin e teknologjisë asistuese dhe pengesës, veçanërisht në arsim, që janë të vetmit në atë fushë në vend.

Përforsimi i ndërgjegjes dhe informimit zbatohet nëpërmjet përpunimit dhe distribuimit të materialeve informative të shtypura dhe elektronike, organizim të ngjarjeve publike debate dhe fushata. Organizata ka faqe-interneti, profil në Fejsbuk (Facebook) dhe kanal në Jutub (YouTube) dhe përdor edhe rrjete të tjera sociale. HD përgatit informator organizativ tremujor, "Pamje nga brenda" në gjuhët maqedonisht dhe anglisht.

Prej vitit 2010 HD është veçanërisht aktive në arsimin e rregullt: organizata futi teknologji asistuese në thuajse 10% të shkollave fillore në vend dhe filloi me pilotimin e zbatimit të teknologjisë asistuese në arsimin e mesëm. Në vitin 2013, vendi për herë të parë siguroi mjete buxhetore për furnizim me pajisje asistuese për sigurim të pajisjeve plotësuese për shkollat partnere të HD.

Në gjysmën e dytë të vitit 2014, HD e filloi zbatimin e projektit të saj të parë jashtë vendit. Projekti parashikon futje të teknologjisë asistuese në arsimin e rregullt në Sërbi sipas modelit të zhvilluar nga HD. Organizata jep mbështetje konsultative dhe këshillëdhënëse për organizatën partnere serbe [EXO](#).

Në vitin 2014, HD filloi hulumtim kombëtar që sillet për gjendjen e personave me pengesë në Maqedoni. Për herë të parë nga themelimi, një hulumtim i HD nuk është i kufizuar në pyetje të lidhura me teknologjinë asistuese, por e përfshin respektimin e të drejtave njerëzore dhe qytetare të personave me pengesë në përgjithësi. Ky angazhim e shpreh vlerësimin se përfshirja e personave me pengesë është supozim kyç për e-përfshirjen e tyre (përfshirjen elektronike).

HD filloi të bashkëpunojë me shoqata për persona më të moshuar në vitin 2012, në iniciativa të përbashkëta për promovimin e teknologjisë asistuese tek qytetarët më të moshuar. Organizata shqyrtoi interesin dhe nevojat specifike të popullatës së moshuar në pikëpamje të përfshirjes dixhitale.

Burim kryesor i mjeteve për HD janë donatorët ndërkombëtarë. Punimi i projekteve të financuara nga USAID dhe BE është pasqyrim i kapacitetit të përforcuar të organizatës për udhëheqje me projekte, por në të njëjtën kohë edhe mundësi për mësim të mëtejshëm nëpërmjet punës. Nga ana tjetër, pjesëmarrja dominante e këtyre donatorëve ndërkombëtarë në buxhetin e përgjithshëm të organizatës paraqet rrezik për qëndrueshmërinë e saj.

Organizata herë pas here fiton mjete nga sektori i biznesit, kryesisht në shumë më të vogël dhe në formë të mbështetjes institucionale ose mbështetje në pajisje.

HD është organizatë e lidhur mirë në rrjet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Organizata është anëtare aktive e dy rrjeteve europiane: [EASPD](#) dhe [Telecentre Europe](#) dhe ka përvojë pozitive me bashkëpunimin me palë nga sektori qytetar, publik dhe sektori i biznesit.

HD është fitues i Çmimit për integrim social i Fondacionit ERSTE në vitin 2013 dhe fitues i çmimit për inkluzion dixhital i [UNITE IT](#) në vitin 2014, si edhe fituese e çmimeve të tjera kombëtare dhe lokale.

Raporti nga holignoza e HD, i përpunuar nga firma konsulente Qendra DETRA drejt fundit të vitit 2013, jep tregim të detajuar të gjendjes organizative dhe është e shfrytëzuar si bazë në planifikimin e strategjisë Organizative të HD 2015 - 2017.

Definim të termave kyçe

Si organizatë që vepron në një fushë relativisht të re në komunitetin maqedonas, HD kontribuon edhe për përcaktimin e termave përkatës në gjuhën maqedonase me teknologji asistuese. Termat kyçe në punimin e HD janë:

Teknologji asistuese (assistive technology) përfshin pajisje, aparate ndihmë dhe softuer që e lehtësojnë dhe mundësojnë përdorimin e teknologjisë nga ana e njerëzve që nuk mund të përdorin ose kanë vështirësi për t'i përdorur zgjidhjet standardet. Teknologjia asistuese përfshin pajisje asistuese kompjuterike (në kuptimin më të gjerë duke përfshirë: pajisje desktop, laptop, tablet, pajisje mobile etj.) pajisje - harduer dhe softuer që u mundësojnë njerëzve në mënyrë të papenguar përdorim të teknologjive informativo - komunikuese. Pajisjet kompjuterike asistuese janë aparate ndihmë të dizajnuara në mënyrë speciale që e lehtësojnë përdorimin e kompjuterit, si për shembull, tastiera me butona të mëdha, klike të veçuara, xhojstik asistues ose të përshtatur (të adaptuar), trakboll etj. Softuer asistues nënkupton softuer të dizajnuar në mënyrë speciale për nevojat e personave që hasin vështirësi gjatë përdorimit të programeve dhe aplikacioneve standarde softuerike.

Nën **teknologji qasëse** (accessible technology) nënkuptohet teknologjia që është e destinuar për të gjithë, në pajtueshmëri me parimin për [dizajn universal](#) dhe [standardet W3C për qasje - interneti](#). Në harduerin qasës përkasin pajisjet standarde kompjuterike që pa vështirësi të veçanta, mund të jenë të pëdorura nga grup më i gjerë përdoruesish. Për shembull, monitori me prekje ose tabletët nuk janë pajisje asistuese, por mund të jenë të pëdorura dhe nga persona me pengesë që kanë problem me përdorimin e një pjese të pajisjeve standarde kompjuterike. Përkatesisht, softuer qasës përfshin programe softuerike dhe aplikacione të destinuara që mundësojnë përdorim të barabartë nga ana e grupit më të gjerë të përdoruesëve: persona me pengesë, persona më të moshuar, persona me nivel të ulët të shkollimit ose persona që nuk e flasin gjuhën në të cilën është ofruar informacioni, persona që përdorin koneksion më të dobët interneti ose teknologji më të vjetra. Përdorues të rinj ose të përkohshëm etj.

E-qasje (qasje elektronike) do të thotë mundësim i qasjes në teknologjitë informativo - komunikuese për të gjithë, në mënyrë që i plotëson nevojat e ndryshme të njerëzve.

Qasje-interneti sillet në faqe - interneti, përmbajtje - interneti dhe softuer që janë mjaft fleksibile që tu përgjigjen nevojave të ndryshme dhe prioriteteve të përdoruesit. Qasje - e internetit nënkupton respektim të [standardeve W3C për qasje - interneti](#) në pikëpamje të përmbajtjes, kontrastit, nevigacionit dhe kompatibilitetit me teknologji të tjera.

E-përfshirje (përfshirje elektronike) (inkluzion dixhital, e-inkluzion) do të thotë pjesëmarrje efektive e të gjithë personave në çdo aspekt të jetës shoqërore nëpërmjet përdorimit të teknologjive informativo - komunikuese.

Qendër për teknologji asistuese sillet në pjesën e strukturës organizative të HD që funksionon si shërbim servisor dhe i ofron këto tre lloje shërbimesh: mbështetje individuale për përdorim të kompjuterit dhe internetit, vlerësim individual të nevojave nga teknologjia asistuese dhe mbështetja këshillëdhënëse - konsultative për zbatim të teknologjisë asistuese.

Shërbime këshillëdhënëse (për teknologji asistuese) është term që përdoret për tre lloje shërbimesh në Qendrën për teknologji asistuese të HD.

SYNIME AFATGJATA

Pas thujse ekzistimit dhjetëvjeçar, HD i ndryshon synimet afatgjata, në mundim që ta shfrytëzojë në mënyrë maksimale kapacitetin e ndërtuar, kredibilitetin dhe arritjet për përshtatje të ndryshimeve në mjedisin dhe nevojat e ndryshuara të përdoruesëve.

Vizioni dhe misioni

Vizioni i HD është botë e njerëzve të barabartë dhe aktivë që e përdorin teknologjinë për zhvillim personal, përmirësim të kualitetit të jetës dhe për mirëqënien e bashkësisë.

Kontributi personal për të mirën e përbashkët është formë e lartë e pjesëmarrjes së individit në jetesën shoqërore. E drejtë dhe detyrim i çdo individ është të kontribuojë në shoqërinë sipas aftësive dhe mundësive të tij. Kontributi i çdokujt është po aq i rëndësishëm.

Çdo bashkësi njerëzore përparon aq sa mund të ketë sukses t'i aftësojë dhe motivojë anëtarët e saj të kontribuojnë për mirëqënien e përbashkët. Detyrim dhe përfitim kyç për çdo bashkësi është zhvillimi i plotë i aftësive dhe nxitja e pjesëmarrjes të të gjithë anëtarëve të saj.

Teknologjia bashkëkohore i përparon mundësitë për zhvillim personal dhe kontribuon për përmirësimin e kualitetit të jetës. Këto përfitime duhet të jenë të disponueshme për të gjithë. Teknologjia duhet tu përshtatet njerëzve dhe jo anasjelltas.

Bota është shtëpia jonë e përbashkët. Secili prej nesh më vete dhe të gjithë së bashku mundemi dhe duhet ta bëjmë shtëpinë vend më të bukur jetese. HD në teknologjinë sheh vegla që mundësojnë secili prej nesh të kontribuojë për përmirësimin.

Misioni i HD është që me teknologji asistuese ta nxitë dhe lehtësojë përfshirjen aktive të të gjithë njerëzve në botën bashkëkohore.

HD zhvillon dhe promovon zgjidhje të reja dhe alternative për krijim të shoqërisë inkluzive informative. Organizata e përdor teknologjinë asistuese dhe teknologjinë informativo-komunikuese në përgjithësi që të mundësojë që të gjithë njerëzit të marrin pjesë në shoqëri në mënyrë aktive. HD synon dhe kontribuon për ndryshime që do ta përmirësojnë e-qasjen (qasjen elektronike) në botën bashkëkohore dhe zbatimin e parimit në dizajn universal.

Në veprimin e saj HD fokusohet tek personat me pengesë, por i merr parasysh nevojat e personave më të moshuar dhe të gjithë personat e tjerë që kanë nevojë për zgjidhje asistuese dhe jostandarde që të përfshihen në hapësirën dixhitale gjithnjë e më të rëndësishme.

Zona primare e veprimit të HD është Maqedonia; mundimet kryesore janë të drejtuara drejt përmirësimit të gjendjeve në vend. Organizata gjithashtu nxit dhe merr pjesë në iniciativa relevante në vendet fqinjë dhe në nivel europian dhe ndërkombëtar, që është pasqyrim i kuptimit të ndërvarësisë së botës bashkëkohore dixhitale.

Vlera dhe parime

Vlerat e HD dalin nga **besimet** se:

- përdorimi dhe zhvillimi i teknologjive informativo - komunikuese e mundësojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë njerëzve në shoqëri, dhe

- informacionet dhe dija janë të mira (publike) të përgjithshme .

Në **fokusin** e HD janë **njerëzit** dhe nevojat e aftësitë e tyre **individuale**.

Punimi i organizatës themelohet në dy **qasje** themelore: qasje të drejtuar drejt **personit** (person-centered) dhe qasje të themeluar mbi **të drejta** (rights-based approach).

Organizata udhëhiqet nga këto **parime dhe vlera**: pjesëmarrja, mundësi të barabarta, tolerancë, partneritet dhe transparencë e përgjegjësi.

Pjesëmarrja nënkupton mundësi që të gjithë të marrin pjesë në punët publike të bashkësisë dhe të kontribuojnë në të. HD beson se njerëzit kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset më të gjera shoqërore që i prekin, për çka, grupeve të marginalizuara u është e nevojshme mbështetje. Në nivel organizativ, përfshirja e përdoruesëve dhe grupeve qëllimore në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e punës së organizatës është e një rëndësie thelbësore.

Parimi i **mundësive të barabarta** do të thotë se të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje të barabartë ndaj përfitimeve nga ndryshimet dhe zhvillimet shoqërore, ekonomike, politike dhe teknologjike. HD kontribuon për krijim dhe përmirësim të mekanizmave shoqërorë për sigurim të mundësive të barabarta, pa diskriminim të çfarëdo baze. Organizata siguron mundësi për përfshirje të të gjithë njerëzve në trupat vetjake ekzekutive, drejtuese dhe aktiviteteve.

Toleranca paraqet përgatitje që të njihen dhe respektohen vlerat dhe sjelljet e të tjerëve. Toleranca është baza kyçe për kohezionin dhe stabilitetin e një shoqërie. Nëpërmjet punës së saj, HD promovon tolerancën dhe respektimin e dallimeve në shoqëri; në mënyrë interne, organizata ndërton mekanizma dhe praktika për drejtim dhe udhëheqje të themeluara mbi këto vlera.

Partneriteti nënkupton përkushtim për bashkëpunim me të gjitha palët e përfshira, të themeluara në besimin reciprok dhe me respektin e ndërsjellë të të drejtave dhe detyrimeve. Një fjalë e urtë thotë: "Nëse dëshiron të shkosh shpejt, shko vetëm. Nëse dëshiron të shkosh larg, shko së bashku me të tjerë". HD është e përkushtuar për ndërtim të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe partneritetit në rrugën e gjatë drejt realizimit të vizionit dhe misionit.

Transparenca dhe përgjegjësia shënojnë publik (në kuptim të kontrollit publik) dhe hapje të proceseve shoqërore dhe institucione dhe mekanizma që sigurojnë sjellje përgjegjëse të përbërësve shoqërorë. HD është dhe do të mbetet shembull për organizatë transparente dhe përgjegjëse, që ta mbajë kredibilitetin që t'i promovojë këto parime në shoqëri.

Këto vlera dhe parime të HD janë pasqyrim i respektimit të deklaratës Universale për të drejta nejrëzore, Konventa e KB për të drejtat e personave me pengesë dhe dokumente të tjera ndërkombëtare që sillen për të drejtat e njerëzve, qytetarëve dhe grupet e marginalizuara mbi çfarëdo lloj baze.

Qëllime afatgjata

Veprimi i HD është i drejtuar drejt këtyre qëllimeve afatgjata:

- teknologji informativo - komunikuese të disponueshme për të gjithë,
- arsim inkluziv dhe modern
- mundësi të barabarta për të gjithë dhe
- HD - organizatë inovative me kredibilitet dhe aftësi për partneritete

Teknologji informativo - komunikuese të disponueshme për të gjithë

Disponueshmëria e teknologjisë informativo - komunikuese është parakusht që të gjithë njerëzit të kenë qasje të barabartë ndaj përfitimeve nga zhvillimi i saj.

HD e përmirëson disponueshmërinë e teknologjisë informativo - komunikuese për të gjithë personat që kanë nevojë për zgjidhje asistuese ose qasëse, nëpërmjet:

- sigurimit të shërbimeve këshilluese për teknologji asistuese
- hulumtim dhe zhvillim të risive dhe përshtatjeve harduer dhe softuer asistuese dhe qasëse,
- sigurim të pajisjeve harduer dhe softuer asistuese dhe qasëse me çmime të arritshme,
- përpunim të materialeve resurse: manuale, udhëzues, udhëheqës etj.,
- përforsim të kapaciteteve të palëve të tjera,
- përforsim të ndërgjegjes dhe informim të publikut të përgjithshëm dhe profesional, dhe
- përfaqësim për mbështetje nga sektori publik për përmirësim të disponueshmërisë së teknologjisë për grupet e marginalizuara.

Shërbimet këshilluese janë bazë nisjeje për zhvillim të praktikave të mira, përcaktim të nevojave, hulumtime dhe zhvillim edhe për përforsim të ndërgjegjes dhe përfaqësim. Ato e sigurojnë legjitimitetin e aktiviteteve të HD të drejtuara ndaj palëve të tjera të përfshira dhe bashkësisë më të gjerë shoqërore.

Arsim modern dhe inkluziv

Arsimi është faktor kyç për mobilitet social afatgjatë.

Sistemi arsimor inkluziv dhe modern krijon individë globalisht konkurrues dhe fuqi punëtore me aftësi dhe dije bashkëkohore, në të njëjtën kohë duke ofruar mundësi të barabarta arsimore për të gjithë nxënësit. Ky sistem pasqyron barazinë, diversitetin dhe demokracinë e shoqërisë dhe është i themeluar mbi zbatim të gjerë të teknologjisë informativo - komunikuese në procesin e të mësuarit.

Kontributin e vet ndaj arsimit inkluziv dhe modern, HD e realizon nëpërmjet:

- përforsimit të kapaciteteve të institucioneve arsimore për zbatim të zgjidhjeve asistuese dhe qasëse në punimin e tyre të përditshëm,
- mbështetje teknike, duke përfshirë sigurim të pajisjeve asistuese qasëse dhe softuer për institucionet arsimore,
- përpunim të materialeve të përkushtuara burimore për zbatim të zgjidhjeve asistuese dhe qasëse në institucionet arsimore,
- zhvillim të aplikacioneve softuerike qasëse arsimore,
- përforsim të ndërgjegjes dhe informimit të publikut të përgjithshëm dhe profesional dhe
- përfaqësim për zbatim sistematik të teknologjisë qasëse dhe asistuese informativo - komunikuese në arsim.

Në fokusin e veprimit të HD janë të gjitha nivelet e sistemit të rregullt arsimor, pas saj duke u përkushtuar vëmendje më të madhe niveleve të detyrueshme të arsimit: fillor dhe arsimit të mesëm. Në të njëjtën kohë, organizata e mbështet zbatimin e teknologjisë asistuese dhe qasëse informativo - komunikuese në arsimin joformal dhe për nxitje të mësimin të përgjithshëm.

Me përjashtim, HD e mbështet zbatimin e teknologjisë asistuese dhe qasëse informativo - komunikuese në arsimin e veçantë, kur ajo nuk është në kundërshtim me përkushtimin e organizatës për realizim të së drejtës për arsim të rregullt për fëmijët dhe të rinjtë me pengesë.

Mundësi të barabarta për të gjithë

Mundësitë e barabarta janë parakusht për përfshirje aktive të të gjithë fëmijëve në jetën shoqërore.

Teknologjia është vegël për sigurim të mundësive të barabarta për të gjithë. Ajo është aq e rëndësishme në shoqëritë bashkëkohore të informacionit të themeluara në informacione dhe dije.

HD kontribuon për mundësi të barabarta për të gjithë personat, duke përdorur teknologjinë asistuese dhe informativo - komunikuese në këto fusha:

- mbështetje të punësimit dhe mundësim të qasjes në tregun e lirë të punës,
- mbështetje në jetën e pavarur në bashkësi,
- nxitje të zbatimit të teknologjisë qasëse informativo - komunikuese dhe asistuese në kuadër të shërbimeve sociale ekzistuese dhe llojet e tyre që ende janë për tu zhvilluar,
- mbështetje të aktivizimit qytetar dhe pjesëmarrje,
- lehtësim të komunikimit dhe informimit,
- përforsim të ndërgjegjes dhe informim të publikut të përgjithshëm dhe profesional, dhe
- përfaqësim për zbatim sistemik të teknologjisë qasëse informativo - komunikuese dhe asistuese në shoqëri.

Gjithashtu, duke e gëzuar faktin se inkluzioni dixhital (e-përfshirja) (përfshirja elektronike) nuk është e mundur pa inkluzion më të gjerë shoqëror, aktivitetet e HD përfshijnë:

- përforsim të ndërgjegjes për nevojën për zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe akteve ligjore që promovojnë mundësi të barabarta dhe inkluzion;
- përfaqësim për zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe akteve ligjore që promovojnë mundësi të barabarta dhe inkluzion;

HD - organizatë inovative me kredibilitet dhe aftësi për partneritete

Inovacioni është angazhimi kyç i HD: organizata nxit dhe udhëheq zgjidhje inovative me zbatim të teknologjisë informativo - komunikuese dhe asistuese, që të mundësojë të gjithë personat të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën në bashkësi.

Resurs kyç, përsëri, për inovacionin janë resurset njerëzore - njerëzit në trupat drejtuese dhe zyrën ekzekutive. HD është e përkushtuar për zhvillim të njerëzve në organizatë në drejtim të integritetit dhe përkushtimit individual dhe profesional, nëpërmjet mundësive për trajnime dhe arsim të vazhdueshëm dhe nxitje të mësimit gjatë punës. HD ndërton kulturë organizative që nxit inovacion dhe zhvillim të zgjidhjeve alternative në të gjitha nivelet, si në pikëpamje të veprimit publik, ashtu edhe në pikëpamje të drejtimin të brendshëm, udhëheqjes dhe strukturës. Përkushtimi i mësimin përfshin përforsim të mekanizmave për mësim dhe zhvillim organizativ, të themeluar në dokumentim, mbikëqyrje dhe vlerësim të aktiviteteve dhe arritjeve vetjake.

Inovacioni, profesionalizmi dhe përkushtimi i veprimit transparent dhe përgjegjës e përforsojnë kredibilitetin dhe njohjen e HD, në mënyrë të barabartë si edhe punën këshilluese të suksesshme në fushën e teknologjisë asistuese.

Aftësia për bashkëpunim dhe partneritete është karakteristika e dytë kyçe e HD: Organizata është e pavarur, por nuk funksionon në mënyrë të izoluar, duke u fokusuar në vetvete. Përkundrazi, HD ndërton marrëdhënie bashkëpunimi dhe partneritete efektive me palë nga sektori qytetar, publik dhe sektori i biznesit.

Përveç se në vend, HD ndërton partneritete edhe në nivel ndërkombëtar. Ajo mundëson që organizata të marrë pjesë në mënyrë aktive në shkëmbimin gjithnjë e më dinamik dhe më të rëndësishëm të përvojave dhe informacioneve në botën bashkëkohore dixhitale.

PRIORITETE STRATEGJIKE

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë organizative të HD 2015 - 2017 është kontributi ndaj realizimit të qëllimeve afatgjata të organizatës.

Qëllimi i strategjisë është kapaciteti i përforcuar i HD për zhvillim të shërbimeve të reja si përgjigje të nevojave dinamike të përdoruesëve.

Fokusi organizativ është përmirësim i strukturës organizative, mësimi dhe proceset e brendshme, Ajo do ta lehtësojë zhvillimin e shërbimeve të reja dhe do të sigurojë bazë për qendrueshmëri afatgjate të organizatës.

Prioritetet strategjike janë të paraqitura më poshtë në katër fusha: përdorues, mësim dhe zhvillim, procese të brendshme dhe financa.

Përdorues

Gjendja aktuale

Nga themelimi deri tani, grupi qëllimor i HD janë personat me pengesë. Organizata siguron direkt shërbime dhe produkte (në tekstin e mëtejshëm: shërbime) për ta, por duke u munduar që ta përmirësojë gjendjen e tyre, përdorues të shërbimeve të HD janë numër gjithnjë e më i madh palësh të përfshira dhe të prekura: shkolla, mësues, institucione arsimore, institucione të tjera relevante, organizata qytetare, sektori i biznesit dhe punëdhënës dhe publiku i përgjithshëm, Lloji i shërbimeve për çdo grup përdoruesish janë të përshkruara shkurtër në pjesën Përshkrim të gjendjes organizative.

Në ekzistimin e deritanishëm, HD e vazhdon vazhdimisht vëllimin dhe llojin e shërbimeve, duke e mbajtur në nivel të lartë ose duke e përmirësuar kualitetin e tyre.

Shërbimet e reja që i zhvillon HD kanë komponentë të fuqishme inovative, që i mundëson organizatës t'i plotësojë nevojat e përdoruesëve, por edhe të mbetet lider në fushën e teknologjisë asistuese në vend dhe në Ballkan.

Gjatë dorëzimit të shërbimeve, organizata promovon qasje të drejtuar ndaj personit dhe porositi shërbime "të përshtatura" (të individualizuara). HD është veçanërisht e njohur për shërbimet që ua ofron personave me pengesë nëpërmjet Qendrës për teknologji asistuese dhe sipas angazhimit në arsimin e rregullt fillor.

Përfshirja e përdoruesëve në vlerësimin e nevojave, planifikim, dorëzim dhe vëlerësim të shërbimeve është e një rëndësie themelore. Edhe pse ekzistojnë procedura dhe rregulla të shkruara, kjo vlerë është e ndarë qartësisht ndërmjet të punësuarëve në HD dhe zbatohet në mënyrë të vazhdueshme.

Në disa vitet e kaluara, HD i bëri hapat e para për bashkëpunim me personat më të moshuar dhe shoqatat e tyre, duke pasur parasysh interesin e tyre të zmadhuar për nevojën e zgjidhjeve jostandarde për përdorim të teknologjisë informativo - komunikuese.

Të gjitha shërbimet e HD nga themelimi deri tani janë pa pagesë për përdoruesit.

Përfshirje

